

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	18.08.2020.
Për/ Za/ To:	ALBKOS INT SH.P.K.
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/ A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës 18.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik ALBKOS SAFETY SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me kompresor 250 l - min"**, me Nr. të Prok: **616 20 069 121** nxjerr::

V E N D I M

- Aprovohet pjesërisht** kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: ALBKOS INT SH.P.K., e parashtruar me datë: 18.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi me kompresor 250 l - min"**, me Nr. të Prok: **616 20 069 121**, kundër *Njoftimit për Vendim për dhënie* të AK -së, të datës **14.08.2020** të publikuar në web-faqe të KRPP-së , në bazë të nenit 108/ A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.
- Korrigjohet** – Letër Standarde në pjesën e arsytimit për eliminim të Operatorit Ekonomik: ALBKOS INT SH.P.K.
- Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me kompresor 250 l - min"**, me Nr. të Prok: **616 20 069 121** dhe mbështet njoftimin për dhënie të kontratës ;
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 14.08.2020 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me datë 18.08.2020 përfaqësuesi i nga Operatori Ekonomik: ALBKOS INT SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Vendimit të AK-së të datës 14.08.2020.

I. Baza Ligjore për parashtrim të Kërkesës për Rishqyrtim

Autoriteti Kontraktues me datë 14.08.2020 iu ka dërguar letrat standarde i sukseshëm, i pasukseshëm, i eliminuar OE ekonomik, ndërsa po me atë datë 14.08.2020 ka bërë njoftimin e Vendimit për dhënie të kontratës.

Provë 2: Letër Standarde për OE ankimor dhe OE të rekomanduar për dhënie të kontratës

Provë 3: Njoftimi i Vendimit për dhënie të kontratës 14.08.2020.

Operatori Ekonomik: ALBKOS INT SH.P.K. ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim me datë 18.08.2018 tek Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës

Provë 1: Kërkesa për Rishqyrtim – datë 18.08.2020

III. Pretendimet e OE: ALBKOS INT SH.P.K. lidhur me shkeljen e dispozitave të LPP-së, konkretisht shkeljen e pikës 9.1 seksioni II i dosjes së tenderit.

OE - Ankimor: ALBKOS INT SH.P.K. thekson si në vijim: “Konstatimi i AK Komuna e Prishtinës është i pasaktë, ngase ne kemi ofertuar me kompresor pesha maksimale e të cilit është 128kg, siç mund të shihet në tabelën e specifikimeve teknike, marrë nga katalogu i prodhuesit, të cilin e kemi dorëzuar bashkë me ofertë (faqja 4 e dokumentit 01. 03E CTP 160-320 Allrounder Oil Pump,TÜV Valve 1.pdf):

Edhe përkundër faktit që shihet qartë se bëhet fjalë për një gabim teknik të komisionit vlerësues, AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Nenin 7 – Barazia në Trajtim/Jo- Diskriminimi si dhe nenin Nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve. Duke u bazuar në faktet e përmendura më sipër, kërkojmë nga AK që ta anulojë propozimin për ta dhënie të kontratës OE PMC SHPK, ta kthejë lëndën në rishqyrtim dhe të vendosë në favor të kompanisë sonë, duke qenë se jemi OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët..

II. Baza Ligjore për aprovim të pjesshëm të Kërkesës për Ri-shqyrtim


Autoriteti Kontraktues në bazë të vlerësimit të anëtarëve të komisionit për vlerësim duke analizuar ofertën e juaj dhe gjatë analizimit të detajuar ka vërejtur për një lëshim teknik pasi që në katalogun e ofruar nga ana e juaj si operator ekonomik, Autoriteti Kontraktues ka menduar që ju keni ofertuar me modelin COMTRADE COMPRESSOR – Model: CTP 280 P dhe është bërë një gabim teknik.

Ndërsa Autoriteti kontraktues pas shqyrtimit të detajuar të ofertës me anëtarët e komisionit ka vlerësuar që ju si operator keni ofertuar me modelin COMTRADE COMPRESSOR – Model: CTP 280 E.

Autoriteti Kontraktues bënë korrigjimin e Letrës Standarde për Eliminim, që ju si operator ekonomik eliminoheni për arsye se Kompresori i ofruar ka vetëm 2 valvula mbushëse dhe jo (4) katër siç është kërkuar në përshkrim të çmimit - ashtu siç shihet në katalog dhe në specifika të katalogut që ju keni ofertuar ka vetëm 2 valvula mbushëse.

Provë: Foto e Kompresorit të modelit CTP 280 E dhe Specifikat

Allrounder Series



CTP 160 - 210 - 280 – 320 E3

FILLING DEVICES 300bar, consisting of

Filling unit complete with DIN filling connector G 5/8" DIN 477, filling pressure gauge and high pressure filling hose 1,2 m length with integrated self-venting filling valve

ADDITIONAL FILLING DEVICES 200bar or 300bar, consisting of:

Filling unit complete with DIN filling connector G 5/8" DIN 477, filling pressure gauge and high pressure filling hose 1,2 m length with integrated self-venting filling valve

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

